

VENDIM
Nr.240, datë 31.3.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.55, DATË 26.1.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË
TË PËRKOHSHE, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.55, datë 26.1.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2011, në njësitë e qeverisjes qendrore, është 1265 veta, sipas lidhjeve nr.1, nr.2 dhe nr.3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.”.

b) Pas lidhjes nr.2, bashkëlidhur vendimit, shtohet lidhja nr.3 (me 95 punonjës shtesë), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi të përballohen nga shpenzimet korente të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2011, të njësive të qeverisjes qendrore.

3. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë detajimin e numrit të punonjësve sipas lidhjes nr.3, brenda kritereve të vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha